



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR
TIRANË

Nr.1.Regj.Them.

Nr. 1 VENDIMI

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i mbledhur pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me trup gjykues të përbërë nga:

Gjyqtare: Emona MUÇI (*Kryesuese seance*)
Gjyqtare: Edlira PETRI (*Anëtare*)
Gjyqtar: Asim VOKSHI (*Anëtar*)
Gjyqtar: Gentian MEDJA (*Anëtar*)
Gjyqtare: Alma KOLGJOKA (*Anëtare*)

me sekretare gjyqësore Erjona Torba, sot më datë 18.02.2021, përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen zgjedhore me nr. 1 akti, datë 04.02.2021 që i përket:

Paditës: **Dega e Partisë Demokratike Delvinë**, përfaqësuar nga Kryetari Z. Hari Imeri, me seli pranë godinës së PD, Delvinë (pa pjesëmarrje në gjykim).

I paditur: **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**, përfaqësuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, përfaqësuar në gjykim me autorizim nr. 1132 prot., datë 11.02.2021 nga juristët Z. Olsi Peto dhe Z. Erion Meta.

Person i Interesuar: Majlinda Qilimi, kandidate e shpallur fituese nga zgjedhjet e datës 30.06.2019 si Kryetare e Bashkisë Delvinë (pa pjesëmarrjen në gjykim).

Objekti: 1. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të zgjedhjeve të qeverisjes vendore të datës 30.06.2019 të mbajtura në Republikën e Shqipërisë dhe në Qarkun e Vlorës, si për Kryetarin e Bashkisë dhe për zgjedhjen e

anëtarëve të Këshillit Bashkiak, si votime të dhënë në kundërshtim me nenin 45 të Kushtetutës, nenin 2 të Kodit Zgjedhor dhe në kundërshtim me Dekretin nr. 111/199, datë 10.06.2019 të Presidentit të Republikës, duke vendosur deklarin e pavlefshmërisë së këtyre zgjedhjeve dhe rregullimin e pasojave, duke kthyer situatën zgjedhore në gjendjen e mëparshme para datës 30.06.2019.

2. Për rrjedhojë deklarin absolutisht të pavlefshëm të Vendimit nr. 135, datë 02.07.2019 të KZAZ nr. 88, Qarku Vlorë për zgjedhjen si Kryetar i Bashkisë Sarandë të znj. Majlinda Qilimi si dhe Vendimit nr. 13/1, datë 01.07.2019 të KZAZ nr. 87 Delvinë, për shpalljen e fituesve të anëtarëve të Këshillit Bashkiak Delvinë, si vendime nul, që nuk sjellin asnjë pasojë juridike që rrjedhin nga një proces votimi i pavlefshëm.

3. Deklarin absolutisht të pavlefshëm të Vendimit nr. 23-2019-78, datë 18.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, që ka miratuar Kryetarin e Bashkisë Delvinë, Znj. Majlinda Qilimi, si një vendim nul që nuk sjellë pasojë juridike.

4. Marrjen e masës së përkohshme të sigurimit të padisë, duke vendosur: pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 23-2019-78, datë 18.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë të miratimit të mandatit të znj. Majlinda Qilimi dhe të konstituimit të Këshillit Bashkiak Delvinë, deri në shqyrtimin e çështjes në themel dhe të shqyrtimit të vlefshmërisë së Dekretit nr. 111/199, datë 10.06.2019 të Presidentit të Republikës.

Baza Ligjore:

Nenet 59 dhe 69 të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

Nenet 48, 113, 3, 4/2, 15,45,8611, 92 shkronja "gj" dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Kodi Zgjedhor, nenet, 2, 10, 64, 67, e vijues.

Kodi i Procedurës Administrative nenet 106-112.

Konventa për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore amenduar me

protokollin NR. 11, neni 6.
Nenet 143, 154 e 202 e vijues të Kodit të
Procedurës Civile.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, pasi ftoi palët në seancë gjyqësore, verifikoi
prezencën e tyre dhe dëgjois subjektin e pranishëm

VËREN:

I. PROCEDURA GJYQËSORE

Se paditësi Dega e Partisë Demokratike Delvinë i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë me padinë me objekt “1. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të zgjedhjeve të qeverisjes vendore të datës 30.06.2019 të mbajtura në Republikën e Shqipërisë dhe në Qarkun e Vlorës, si për Kryetarin e Bashkisë dhe për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Bashkiak, si votime të dhënë në kundërshtim me nenin 45 të Kushtetutës, nenin 2 të Kodit Zgjedhor dhe në kundërshtim me Dekretin nr. 111 199, datë 10.06.2019 të Presidentit të Republikës, duke vendosur deklarimin e pavlefshmërisë së këtyre zgjedhjeve dhe rregullimin e pasojave, duke kthyer situatën zgjedhore në gjendjen e mëparshme para datës 30.06.2019.

2. Për rrjedhojë deklarimin absolutisht të pavlefshëm të Vendimit nr. 135, datë 02.07.2019 të KZAZ nr. 88, Qarku Vlorë për zgjedhjen si Kryetar i Bashkisë Sarandë të znj. Majlinda Qilimi si dhe Vendimit nr. 13/1, datë 01.07.2019 të KZAZ nr. 87 Delvinë, për shpalljen e fituesve të anëtarëve të Këshillit Bashkiak Delvinë, si vendime nul, që nuk sjellin asnjë pasojë juridike që rrjedhin nga një proces votimi i pavlefshëm.

3. Deklarimin absolutisht të pavlefshëm të Vendimit nr. 23-2019-78, datë 18.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, që ka miratuar Kryetarin e Bashkisë Delvinë, Znj. Majlinda Qilimi, si një vendim nul që nuk ka sjellë pasoja juridike.

4. Marrjen e masës së përkohshme të sigurimit të padisë, duke vendosur: Pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 23-2019-78, datë 18.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë të miratimit të mandatit të znj. Majlinda Qilimi dhe të konstituimit të Këshillit Bashkiak Delvinë, deri në shqyrtimin e çështjes në themel dhe të shqyrtimit të vlefshmërisë së Dekretit nr. 111 199, datë 10.06.2019 të Presidentit të Republikës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë me Vendimin Nr. 23-2019-1522/680, datë 12.09.2019, ka vendosur:

“Të shpallë moskompetencën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë për shqyrtimin e çështjes nr. regj. them. 2126-01165-23-2019, datë 10.09.2019 regjistrimi, duke ia çuar për gjykim këtë çështje Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.”.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë me Vendimin Nr. 506, datë 16.10.2019, ka vendosur:

“Të parashtrojë përpara Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë mosmarrëveshjen lidhur me kompetencën lëndore të gjykimit të çështjes midis Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.”.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me Vendimin nr. 00-2020-534 datë 12.10.2021, ka vendosur:

Përcaktimin e Kolegjit Zgjedhor si gjykata kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje.

Ndryshimin pjesërisht të Vendimit Nr. 23-2019-1522/680, datë 12.09.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, duke vendosur dërgimin e çështjes për kompetencë në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me Vendimin nr. 00-2020-534/1, datë 13.01.2021 ka vendosur: *“Ndreqjen e gabimit material në vendimin nr. 00-2020-534 datë 12.10.2020 të Kolegjit administrativ të Gjykatës së Lartë si më poshtë: “Togfjalëshi “Kolegji Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë” i pasqyruar në vendimin e mësipërm si në pjesën arsyetuese ashtu dhe në diapozitivin e vendimit duhet të lexohet “ Kolegji Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Ky vendim i bashkëngjitet vendimit nr.00-2020-534 datë 12.10.2020 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe është pjesë përbërëse e tij”.*

II. FAKTET E ÇËSHTJES:

1. Me Dekretin nr. 10 928, datë 05.11.2018 të Presidentit të Republikës *“Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore ”*, është dekretuar *“Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të zhvillohen ditën e diel, më datë 30 qershor 2019.”.*

2. Me Dekretin nr. 11 199, datë 10.06.2019 të Presidentit të Republikës është dekretuar: *“Shfuqizimi i Dekretit nr. 10928, datë 05.11.2018 të Presidentit të Republikës “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, duke anuluar datën 30 qershor 2019, si ditë e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.*

3. Me Dekretin nr. 11 211, datë 26.06.2019 të Presidentit të Republikës *“Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore ”*, është dekretuar *“Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore caktohen për t’u zhvilluar ditën e diel, në datën 13 tetor 2019..”.*

4. Me vendimin nr. 148, datë 11.04.2019 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi: *“Të regjistrojë Partia Socialiste e Shqipërisë”, me kryetar z. Edi Rama, dhe shkronja nistore “PS”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.”*

5. Me vendimin nr. 230, datë 27.04.2019 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi: *“Të regjistrojë Partinë “Bindja Demokratike”, me kryetar z. Astrit Patozi, dhe shkronja nistore “BD”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.”*

6. Me vendimin nr. 251, datë 07.05.2019 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi: *“Të regjistrojë Koalicionin “Aleanca për Shqipërinë Europiane”, (ASE) si subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.”*, me parti pjesëtare 21 në total.

7. Rezulton se në datën 30 qershor 2019, në gjithë territorin e RSH-së janë zhvilluar zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore për kryetar bashkie dhe për këshillat bashkiakë. Sipas akteve të KQZ, nuk rezulton që të jetë regjistruar si subjekt politik Partia Demokratike.

8. Referuar kërkesave të përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, KZAZ-ja nr. 87 Delvinë, Qarku Vlorë, ka regjistruar kandidatët për Kryetar Bashkie dhe listat shumë emërore për kandidatët për Këshillin e Bashkisë Delvinë. Subjekti Politik Partia Demokratike nuk është regjistruar, si subjekt zgjedhor në KQZ dhe rrjedhimisht nuk ka regjistruar as listat shumë emërore për kandidatët anëtar të Këshillit Bashkiak dhe kandidatit për kryetar bashkie.

9. Me vendimin nr. 13, datë 08.07.2019 të KZAZ nr. 87, Vlorë, është miratuar Tabela Përmbledhëse e Rezultateve të Zgjedhjeve *“Për kandidatët për Këshill të Bashkisë Delvinë”*, nga ku rezulton se, i vetmi subjekt zgjedhor pjesëmarrës është Partia Socialiste e Shqipërisë”.

10. Me vendimin nr. 13/1, datë 01.07.2019 të KZAZ nr. 87, Vlorë, është miratuar Tabela Përmbledhëse e Rezultateve të Zgjedhjeve *“Për kandidatët për Kryetar të Bashkisë Delvinë”*, rezulton se i vetmi kandidat i regjistruar është Znj. Majlinda Harun Qilimi.

11. Me vendimin nr. 84, datë 08.11.2019 Kolegji Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit, Tiranë pasi ka marrë në shqyrtim padinë e paraqitur nga paditësi: **“Rigels Balili, Subjekti Politik Dega e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim Delvinë”**, kundër: **“Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”**, me objekt: *“1. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të zgjedhjeve të qeverisjes vendore të datës 30.06.2019, të mbajtura në Republikën e Shqipërisë dhe në Qarkun*

Vlorë për Kryetarin e Bashkisë dhe për zgjedhjet e anëtarëve të Këshillit Bashkiak si votime të dhëna në kundërshtim me nenin 45, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 2 të Kodit Zgjedhor dhe në kundërshtim me Dekretin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë nr. 111199, datë 10.06.2019, duke vendosur rregullimin e pasojave duke kthyer situatën zgjedhore në gjendjen e mëparshme para datës 30.06.2019. 2. Deklarimin absolutisht të pavlefshëm të vendimit nr. 135, datë 02.07.2019, të KZAZ-së nr. 87 Delvinë, Qarku Vlorë për zgjedhjen si kryetar i Bashkisë Delvinë të zj. Majlinda Qilimi, si dhe vendimin nr.13/1, datë 01.07.2019 të KZAZ nr. 87 Delvinë, “Për shpalljen e fituesve të anëtarëve të Këshillit Bashkiak Delvinë”, si vendim nul, që nuk sjellin asnjë pasojë juridike, që rrjedhin nga një proces votimi i pavlefshëm. 3. Deklarimin absolutisht të pavlefshëm të vendimit nr. 23-2019-78, datë 18.07.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë që ka miratuar mandatin e Kryetarit të Bashkisë Delvinë zj. Majlinda Qilimi si një vendim nuk dhe që nuk sjell pasojë juridike të dhënë në kundërshtim me nenet 388, 392 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 60 të ligjit 139/2015. 4. Marrjen e masës së përkohshme të sigurimit të padisë, “ duke **disponuar me “Rrëzimin e kërkesë padisë”**”.

12.Ndër të tjera, ky kolegji ka arsyetuar se:” ...(...) Në Pjesën IV të Kodit Zgjedhor, neni 63 të Kodit përcakton se: “1. Subjekt zgjedhor është një parti politike ose një koalicion partish politike, të cilët paraqesin listë kandidatësh, sipas rregullave që përcaktohen në këtë Kod. 2. Subjekt zgjedhor mund të jetë edhe një shtetas shqiptar me të drejtë vote, i cili propozohet si kandidat për deputet apo për organet e qeverisjes vendore nga një grup zgjedhësish, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Kod.” “Subjekte zgjedhore” janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, të regjistruar në përputhje me këtë Kod. Referuar përcaktimeve ligjore të gjithë subjektet e mësipërme, sipas parashikimeve të vetë dispozitës së sipërcituar, duhet të jenë të regjistruar në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor. Ky parashikim nuk gjen pasqyrim në rastin objekt shqyrtimi. Rezulton se dhe është e dukshme se pala paditëse, Dega e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, nuk ka cilësinë e subjektit zgjedhor e për pasojë, në kushtet e rrethanat konkrete, nuk gëzon legjitimitetin aktiv në kërkimin e saj.

Për sa më sipër Kolegji Zgjedhor vlerëson se padia e paditësit Dega e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim Delvinë duhet të rrëzohet si e pabazuar në ligj, për shkak se nuk plotëson kushtet e parashikuar në neneve 63 dhe 145 të Kodit Zgjedhor, pasi nuk legjitimohet në ankimin e saj.”

III PRETENDIMET E PALËVE NDËRGJYQËSE

13. Pala paditëse Dega e Partisë Demokratike Delvinë pavarësisht njoftimit të rregullt të "Urdhrit" të Kolegjit për caktimin e seancës gjyqësore (datës dhe orës) për shqyrtimin e padisë së paraqitur nga ana e saj, rezultoi se kishte dijeni të rregullt dhe pa asnjë shkak të arsyeshëm nuk u paraqit në seancën gjyqësore të datës 18.02.2021. Gjithashtu rezultoi se nga ana e Kolegjit iu komunikuan edhe parashtrimet e palës së paditur së bashku me provat bashkëlidhur, dhe sipas shënimit të postës, pala paditëse "Refuzoi" marrjen e njoftimit për komunikimin e këtyre akteve.

14. Referuar përmbajtjes së padisë, pala paditëse ka ngritur këto pretendime:

- 14.1 Paditësi si subjekt politik dhe interes legjitim pretendon se zgjedhjet e kryera në datën 30.06.2019 janë zhvilluar bazuar në një Dekret të Presidentit të Shfuqizuar. Në këto kushte kërkohet pavlefshmëria e zgjedhjeve të datës 30.06.2019 si dhe çdo akti që ka dalë në zbatim të këtyre votimeve nga KQZ, KZAZ si vendime nul, dhe në kundërshtim me Kushtetutën dhe Kodin Zgjedhor.
- 14.2 Zgjedhjet e zhvilluara në datën 30.06.2019, janë bazuar në Dekretin nr. 10 928, datë 05.11.2018 të Presidentit të Republikës *"Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore"*, duke anuluar datën 30 qershor 2019".
- 14.3 Me Dekretin nr. 11 199, datë 10.06.2019 të Presidentit të Republikës është vendosur: *"Shfuqizimin e Dekretit nr. 10928, datë 05.11.2018 të Presidentit të Republikës "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore"*, duke anuluar datën 30 qershor 2019, si ditë e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë.
- 14.4 Me marrjen dijeni të Dekretit të Presidentit, mbi anulimin e datës së zgjedhjeve nuk është kryer regjistrimi i këtij subjekti politik pranë KQZ, për shkak të situatës politike të krijuar më vend.
- 14.5 Dekreti për caktimin e datës së zgjedhjeve ishte shfuqizuar e për këtë, data e zgjedhjeve 30.06.2019 nuk ekzistonte më si datë zgjedhjesh. Në këto kushte subjekti nuk mund që të paraqisnim kërkesë pranë KQZ, për tu regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e qeverisjes vendore.
- 14.6 Presidenti Republikës me Dekret nr. 11 211, datë 26.06.2019 ka vendosur se zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të caktohen për t'u zhvilluar ditën e diel, në datën 13 Tetor 2019.

- 14.7 Në këto kushte duke qenë se data e caktuar 30.06.2019 për Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë është shfuqizuar, këto zgjedhje nuk mund që të mbaheshin në datën 30.06.2019.
- 14.8 Neni 93 i Kushtetutës së R.SH, parashikon se të drejtën për të nxjerrë dekrete e ka vetëm Presidenti i Republikës, data 30.06.2019 nuk mund të quhet datë zgjedhje pasi kjo date, është shfuqizuar.
- 14.9 Deri më sot as Gjykata Kushtetuese dhe as Kolegji Zgjedhor në rastin konkret nuk kanë marrë në shqyrtim ligjshmërinë e veprimtarisë së Presidentit të Republikës në nxjerrjen e Dekretit Nr. 11 199 datë 10.06.2019, dhe nga ana tjetër Presidenti në bazë të Kushtetutës ka dekretuar me Dekretin nr. 11 211, datë 27.06.2019 datën 13.10.2019 si datë zgjedhjeve.
- 14.10 Dekreti i Presidentit për caktimin e datës 30.06.2019 si datë zgjedhjeve nuk ekziston më e për këtë nuk mund të mbaheshin zgjedhjet. Kolegji zgjedhor në vendimmarrjen e saj është "gjykatë suigeneris, e krijuar me ligj të veçantë" dhe nuk ka kompetenca ligjore sipas Kodit Zgjedhor për vlerësimin qoftë edhe incidental të pavlefshmërisë së Dekretit që cakton datën e zgjedhjeve apo e shfuqizon atë".
- 14.11 Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të një dekreti të kësaj natyre, mund të bëhet vetëm në rrugë të posaçme gjyqësore, dhe aktualisht deri më sot nuk është paraqitur ndonjë padi në Kolegjin Zgjedhor, kundër dekretit të Presidentit të Republikës, si rrjedhojë data 30.06.2019 nuk ka qenë datë zgjedhje.
- 14.12 Gjithashtu KQZ, nuk ka marrë asnjë vendim për subjektet politike në vendimin e datës 13.06.2019, por vetëm për një subjekt zgjedhor të Partisë së Unitetit Kombëtar.
- 14.13 Pavlefshmëria e dekretit të Presidentit mund të vendoset vetëm me vendim gjykate, dhe ku Presidenti duhet të ishte palë në gjykim. Që në këtë rast nuk ka qenë palë në gjykim edhe pse Kolegji Zgjedhor nuk ka qenë kompetentë, për të marrë në shqyrtim vlefshmërinë e Dekretit të Presidentit të Republikës.
- 14.14 Në këto kushte kur Dekreti nr. 10 928, datë 05.11.2018 i Presidentit të Republikës "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore", të datës 30 qershor 2019, është anuluar nuk mund që të miratohej kërkesa e kandidatit Adrian Gurma për vërtetimin e mandatit nga KZAZ dhe nga KQZ. Gjithashtu KZAZ nuk mund që të nxirrte rezultatet e kandidatëve për anëtarë të Këshillit Bashkiak për arsye se procesi i votimit ishte bërë në kundërshtim me ligjin dhe se subjekti Bindja

Demokratike ishte regjistruar në KQZ, jashtë afateve ligjore.

- 14.15 Me vendimin nr. 148, datë 11.04. 2019 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka vendosur: *Të regjistrojë "Partia Socialiste e Shqipërisë", kryetar z. Edi Rama, dhe shkronja nistore "PS", si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019".*
- 14.16 Me vendimin nr. 251, date 07.05.2019 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka vendosur: *Të regjistrojë Koalicionin "Aleanca për Shqipërinë Europiane", (ASE) si subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.*
- 14.17 Me vendimin nr. 230, date 27.04.2019 Komisionit Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka vendosur: *Të regjistrojë Partinë "Bindja Demokratike", me kryetar z.Astrit Patozi, dhe shkronja nistore "BD", si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019".*
- 14.18 Në vijim të pretendimeve të tij, paditësi citon nenet 9 të ligjit Nr. 8580, datë 17.2.2000 "Për Partitë Politike", si dhe nenet 64 dhe 65 të Kodit Zgjedhor të RSH.
- 14.19 Sipas vendimit nr. 148, datë 11.04. 2019 të KQZ-se rezultoi se, regjistrimi i subjektit zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, të datës 30.06.2019, është bërë, brenda afatit 70 (shtatëdhjetë) ditor të parashikuar, në nenin 64 të Kodit Zgjedhor. Sipas vendimit nr. 251, datë 07.05. 20 19 të KQZ, rezultoi se, regjistrimi i Koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane", (ASE) si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes vendore, është bërë brenda afatit 60 (gjashtëdhjetë) ditor të parashikuar, në nenin 64 të Kodit Zgjedhor.
- 14.20 Sipas faktit vendimi nr. 230, datë 27.04. 2019 te KQZ-së për regjistrimin si subjekt zgjedhor te Partisë "Bindja Demokratike", është marrë në shkelje të hapur me nenin 64 të Kodit Zgjedhor dhe nenin 9 të ligjit "Për Partitë Politike"(ligji material), dhe për rrjedhojë, konstatohet nga gjykata si akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, sipas neneve 108 dhe 109 të Kodit të Procedurave Administrative.
- 14.21 Afati për të paraqitur kërkesë nga partitë politike, është përcaktuar në nenin 64 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, në të cilin thuhet se: *"Çdo parti politike duhet të paraqesë kërkesën për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ jo më vonë se 70 ditë përpara datës së zgjedhjeve".*
- 14.22 Bazuar në nenin 64 të Kodit Zgjedhor, në zgjedhjet e datës 30.06.2019, afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga partitë politike, për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor

në KQZ është përcaktuar data 23.04.2019, pasi data 21 si afat i fundit ishte ditë e Shtunë.

- 14.23 Partia "Bindja Demokratike, me datën 23.04.2019 ka paraqitur kërkesë, pranë KQZ-së, për tu regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, të datës 0.06.2019. Regjistrimi në Gjykatë i Partisë "Bindja Demokratike" është bërë me vendimin nr. 8, datë 25.04.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, Faqja 3 nga 5 vendim i cili ka marrë formë të prerë me datë 10.05.2019.
- 14.24 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka pranuar kërkesën e Partisë Bindja Demokratike dhe ka bërë regjistrimin e kësaj partie si subjekt zgjedhor, me vendimin e sipërcituar në kundërshtim me nenin 64 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, në të cilin parashikohet se: "2. Për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor për çdo lloj zgjedhjeje, një parti politike duhet të paraqesë në KQZ :a) vërtetimin që partia është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë".
- 14.25 Në momentin e paraqitjes së kërkesës "Partia Bindja Demokratike", nuk kishte fituar akoma personalitetin juridik, pasi në mbështetje të nenit 9/2 të ligjit "Për partitë politike", "*Partia politike njihet si person juridik që nga data kur gjykata ta ketë miratuar dhe regjistruar atë*". Gjithashtu Partia "Bindja Demokratike", duke mos qënë e regjistruar në Gjykatë, në momentin e paraqitjes së kërkesës për tu regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, nuk kishte zotësi juridike për të fituar të drejta dhe për të marrë përsipër detyrime, sikurse është marrja pjesë në zgjedhjet e Organeve të Qeverisjes Vendore të datës 30.06.2019.
- 14.26 Sa sipër, rezulton se Partia "Bindja Demokratike" është regjistruar si subjekt zgjedhor nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ-s) në shkëlqje të nenit 64 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë dhe nenit 9 të Ligjit "Për Partitë Politike".
- 14.27 Për raste të ngjashme ka dhe precedentë të mëparshëm, në të cilat KQZ ka rrëzuar kërkesën e subjekteve politike për tu regjistruar si subjekte zgjedhore dhe për të marrë pjesë në zgjedhje, pa pasur me parë, një vendim gjykate të formës së prerë për regjistrimin e tyre në gjykatë.
- 14.28 Në këto kushte gjithë procesi zgjedhor i datës 30.06.2019 është një proces nul dhe çdo vendim i marrë nga KQZ dhe KZAZ për shpalljen fitues të kandidatëve për Kryetar Bashkie dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak është nul dhe i pavlefshëm dhe nuk krijon asnjë pasojë juridike.
- 14.29 Në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008, i ndryshuar me ligjin nr. 74/2012 "Kodi Zgjedhor i Republikës së

Shqipërisë" në nenin 2 "Përkufizime" parashikohet se: *"Data e zgjedhjeve" është data e votimit, e caktuar me dekret të Presidentit të Republikës.* Në nenin 8 "Periudha zgjedhore" parashikon se : *"Zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin apo për njësitë e qeverisjes vendore zhvillohen njëherësh në të gjithë territorin e vendit brenda periudhës që shtrihet nga 15 marsi deri më 30 qershor ose nga 15 shtatori deri më 30 nëntor. Bëjnë përjashtim nga ky rregull rastet e parashikuara në pikat 3, 4, 5 dhe 6 të nenit 9 të këtij Kodi".*

- 14.30 Pra të drejtën e caktimit dhe cdekretimit të datës së zgjedhjeve ligjvënësi ja ka lënë vetëm President të Republikës, sipas nenit 2 "Përkufizime" përcaktohet se: *"Data e zgjedhjeve" është data e votimit, e caktuar me dekret të Presidentit të Republikës.* Pra Presidenti i Republikës ka vepruar bazuar në këtë dispozitë të Kodit Zgjedhor.
- 14.31 Po kështu bazuar në përcaktimet e nenit 10 "Caktimi i datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore" parashikon se : *"Data e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore caktohet me dekret nga Presidenti i Republikës".* Pra të drejtën e caktimit të datës së zgjedhjeve e ka presidenti i cili e ka vlerësuar të arsyeshme që të ri caktojë si datë zgjedhjeve datën 13.10.2019.
- 14.32 Gjithashtu në bazë të nenit 60 të ligjit '39/2015 përcakton se: *"4. Ushtrimi i mandatit të kryetarit të bashkisë fillon në çastin kur bën betimin dhe përfundon kur bën betimin kryetari pasardhës".* Bazuar në këtë dispozitë duke qenë se zgjedhjet e datës 30.06.2019 janë kryer në kundërshtim me Dekretin e Presidentit, mandati si Kryetar i Bashkisë përfundon në datën kur do të kryej betimin Kryetari i Ri i Bashkisë që do të zgjidhet nga zgjedhjet e datës 13.10.2019, për këtë mandati i Kryetarit të ri të votuar është një vendim Nul dhe nuk mund që të miratohej nga gjykata dhe konstituimi i Këshillit Bashkiak nuk mund që të kryhet.
- 14.33 Në interpretim të nenit 110 të K.Pr.Administrative "Pasojat dhe konstatimi i pavlefshmërisë absolute", vlerësohet se vendimi nr.134/11, datë 02.07.2019 i KZAZ është marrë në kundërshtim me ligjin pasi nuk bazohet në Dekretin e Presidentit të Republikës, ai nuk ka nevojë të deklarohet i pavlefshëm nga gjykata në një proces gjyqësor, por konstatohet si i tillë në çdo rast nga gjykata.
- 14.34 Shoqata e Kryetarëve të Bashkive ka paraqitur kërkesëpadi, për pavlefshmërinë e zgjedhjeve të datës 30.06.2019. në këto kushte kërkohet që të vendoset dhe pezullimi i ekzekutimit të vendimit të Gjykatës që ka vendosur miratimin e mandatit në kundërshtim me ligjin,

deri në shqyrtimin e vlefshmërisë së Dekretit nr. 111 199, datë 10.06.2019 të Presidentit të Republikës që ka vendosur: "Shfuqizimin e Dekretit nr. 10928, datë 05.11.2018 të Presidentit të Republikës "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore", dhe pavlefshmërinë e zgjedhjeve të datës 30.06.2019.

- 14.35 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë në kundërshtim flagrant me ligjin, nuk ka marrë në shqyrtim parashtrimet e paditësve dhe ka vendosur në kundërshtim të plotë me Kushtetutën, Dekretin e Presidentit, miratimin e mandatit në një kohë që duhet të vendoste pezullimin e gjykimit të çështjes sipas nenit 297/a të K.Pr.Civile.

15.Me shkresën nr.1 Prot., datë 15.02.2021, pala e paditur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka parashtruar pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, parashtrimet e saj, ku ka propozuar se:

- 15.1** Kërkesë padia e paraqitur nga paditësi, duhet të rrëzohet, pasi i njëjti objekt padie është shqyrtuar nga Kolegji Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit, Tiranë.
- 15.2** Ky Kolegj me vendimin nr. 84, datë 08.11.2019 ka vendosur "Rrëzimin e kërkesë padisë".
- 15.3** Sa më lart, mbështetur në nenin 451/1/a të ligjit 8116, datë 29.03.1966 "Kodi i Procedurës Civile në RSH", i ndryshuar, si dhe nenit 158/3 e ligjit 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i RSH", i ndryshuar, kërkohet rrëzimi i kërkesë padisë.
- 15.4** Kjo palë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr.1 Prot., Date 15.02.2021, (2 fletë) ka paraqitur si prova edhe: (i) Vendim nr.13, datë 08.07.2019, KZAZ Nr.87, Qarku Vlorë "Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Delvinë (1 fletë);(ii) Vendim nr.13/1, datë 01.07.2019, KZAZ Nr.87, Qarku Vlorë "Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Delvinë (1 fletë); (iii) Tabelë përmbledhëse e rezultateve, KZAZ Nr.87, "Për kandidatët për Kryetar të Bashkisë Delvinë" (2 fletë); (iv) Vendim gjyqësor nr.12, datë 24.06.2019, Kolegji Zgjedhor, Gjykata e Apelit Tiranë (21 fletë) + mendim paralel (8 fletë) +mendim paralel (2 fletë); (v) Vendim gjyqësor nr.84, datë 08.11.2019, Kolegji Zgjedhor, Gjykata e Apelit Tiranë (9 fletë) + shkurtim vendimi (3 fletë).

16. Personi i tretë në këtë gjykim pavarësisht njoftimit të rregullt të "Urdhrit" të Kolegjit për caktimin e seancës gjyqësore (datës dhe orës) për shqyrtimin e padisë rezultoi se ka marrë njoftimin në datën 09.02.2021 dhe nuk i parashtrroi këtij Kolegji ndonjë parashtrësë apo prova, dhe po ashtu nuk u paraqit në seancën e datës 18.02.2021, pa ndonjë shkak të arsyeshëm.

II. LIGJI I ZBATUESHËM

17. Neni 2(20) i Kodit të Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë (siç ka qenë në fuqi në momentin e paraqitjes së padisë në gjykatë) parashikon se:

“20. “Subjekte zgjedhore” janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, të regjistruar në përputhje me këtë Kod.”

18. Neni 63(1)(2) i Kodit Zgjedhor parashikon se:

“1. Subjekt zgjedhor është një parti politike ose një koalicion partish politike, të cilët paraqesin listë kandidatësh, sipas rregullave që përcaktohen në këtë Kod.

2. Subjekt zgjedhor mund të jetë edhe një shtetas shqiptar me të drejtë vote, i cili propozohet si kandidat për deputet apo për organet e qeverisjes vendore nga një grup zgjedhësish, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Kod.”

19. Neni 124 i Kodit Zgjedhor: “1. Çdo parti politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni, dhe kandidati i propozuar nga zgjedhësit kanë të drejtë të ankohen në KQZ kundër vendimeve të KZAZ-së, që cenojnë interesat e tyre të ligjshëm, brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së vendimit. 2. Kundër vendimit të KZAZ-së për shpalljen e rezultatit për zgjedhjet e organeve të njëjësive të qeverisjes vendore nën juridiksionin e saj, të marrë sipas nenit 122 të këtij Kodi, mund të paraqitet ankim në KQZ jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e vendimit për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore. Ankimi ndaj vendimit mund të përmbajë ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi. 3. Kundër vendimit të KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, të marrë sipas nenit 123 të këtij Kodi, mund të paraqitet ankim po në KQZ jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e këtij vendimi. Ankimi ndaj vendimit mund të përmbajë ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi. 4. Në çdo rast ankimi për pavlefshmëri, sipas nenit 160, dhe ankimi për ndryshimin e tabelës së rezultatit paraqitet në të njëjtën kërkesë ankimore, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni. Në kërkesë përcaktohen qendrat e votimit, për të cilat kërkohet ndryshimi i rezultatit apo pavlefshmëria...”

20. Neni 145 i Kodit Zgjedhor parashikonte se:

“1. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në

nenin 152 të këtij Kodi. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor.

2. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor për mosmarrje të vendimit brenda afatit ligjor nga KQZ-ja. Në këtë rast Kolegji Zgjedhor nuk e gjykon çështjen në themel dhe, kur pranon kërkesën, vendos detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim. Përrjashtim nga ky rregull bëjnë vendimet e KQZ-së për rrëzimin e kërkesës ankimore në lidhje me vendimet të marra në përputhje me shkronjat “a”, “b” “c” dhe “ç” të nenit 24 të këtij Kodi.

3. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe subjektet e përmendura në nenin 6 të këtij Kodi, të cilëve u është refuzuar kërkesa për akreditimin e vëzhguesve. Në rastet kur akreditimi i vëzhguesve u delegohet KZAZ-ve, atëherë e drejta e ankimit, sipas kësaj pike, fillon me ankimin administrativ, në përputhje me nenin 124 të këtij Kodi.”

21. Neni 158 i Kodit Zgjedhor parashikon se:

“1. Në varësi nga çështjet në shqyrtim, Kolegji Zgjedhor vendos:

- a) pushimin e gjykimit;
- b) gjykimin e çështjes në themel; ose
- c) detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim.

2. Pushimi i gjykimit vendoset kur Kolegji Zgjedhor konstaton se ankimi është paraqitur jashtë afateve të përcaktuara në këtë Kod ose për mungesë kompetence. Kur Kolegji Zgjedhor vendos mungesën e kompetencës, ia dërgon çështjen organit kompetent.

3. Me gjykimin e çështjes në themel, Kolegji Zgjedhor vendos pranimin e plotë apo të pjesshëm të padisë ose rrëzimin e plotë apo të pjesshëm të saj.

4. Kolegji Zgjedhor vendos detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim, në zbatim të pikës 2 të nenit 145 të këtij Kodi. Në këtë rast Kolegji Zgjedhor cakton afat të prerë për marrjen e vendimit jo më të gjatë se 10 ditë.

5. Vendimi i Kolegjit Zgjedhor është i formës së prerë. Ndaj tij nuk bëhet ankim.

6. Kolegji Zgjedhor është i detyruar të zbardhë vendimin jo më vonë se tre ditë nga data e dhënies së tij.”

III. VLERËSIMI I KOLEGJIT ZGJEDHOR GJYQËSOR

22. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor e zhvilloi seancën pa pjesëmarrjen e palës paditëse. Në momentin e verifikimit të prezencës së palëve në këtë gjykim rezultoi se pala paditëse **Dega e Partisë Demokratike Delvinë**, përfaqësuar nga Kryetari Z. Hari Imeri ishte njoftuar në adresën Lagjja “Sinan Ballaci”, Delvinë dhe gjithashtu edhe në selinë qendrore të Partisë Demokratike Tiranë, njoftime të cilat janë nënshkruar rregullisht në rubrikën e “marrësit”. Gjithashtu nga ana e këtij Kolegji, kësaj pale i janë komunikuar edhe aktet e paraqitura nga pala e paditur, marrja e të cilave u refuzua.

23. Në seancë u paraqitën me autorizim juristët e palës së paditur të cilët pretenduan se:“...(...) Kërkesë padia e paraqitur nga paditësi, duhet të rrezohet, pasi i njëjti objekt padie është shqyrtuar nga Kolegji Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit, Tiranë. Ky kolegji me vendimin nr. 84, datë 08.11.2019 ka vendosur “Rrëzimin e kërkesë padisë”.

23.1 Në kushtet kur kjo palë ka paraqitur në gjykim “Deklaratën e Mbrojtjes”/parashtrimet, nga ana e Kolegjit u pyet në lidhje me qëndrimin e saj (palës së paditur) për vijimin e seancës në kushtet e mosparaqitjes së palës paditëse. Pala e paditur në seancë deklaroi se *e linte këtë çështje në çmim të Kolegjit.*

24. Ndodhur në këto rrethana fakti, Kolegji mbajti në vëmendje përmbajtjen e nenit 179/2 të K.Pr.Civile me titull “*Pasojat juridike të mosparaqitjes së palëve*”, (Ndryshuar me ligjet nr. 8812, datë 17.5.2001dhe nr. 38/2017, datë 30.3.2017) në të cilin parashikohet shprehimisht se: “1. (...) **2. Nëse paditësi, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqitet në seancë përgatitore ose në seancë gjyqësore dhe rezulton se ka dijeni rregullisht, gjykata vendos pushimin e gjykimit, kur i padituri nuk ka dorëzuar deklaratën e mbrojtjes. Kur i padituri e ka dorëzuar deklaratën e mbrojtjes, mund të kërkojë vijimin e gjykimit në mungesë të paditësit dhe gjykata, kur vlerëson se qëndrimi i të paditurit ka shkak të ligjshëm, vijon gjykimin në mungesë të paditësit. ...**”

25. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor për sa më sipër, vlerësoi se nuk ka asnjë shkak të ligjshëm për vijimin më tej të këtij gjykimi duke analizuar edhe sa vijon:

25.1 Ky Kolegji ka kompetencë lëndore dhe funksionale për gjykimin e çështjes objekt shqyrtimi sipas parashikimeve të nenit 145 të Kodi Zgjedhor të ndryshuar. Po sipas këtij neni, i cili përcakton edhe rrethin e subjekteve, që kanë të drejtë t’i drejtohen Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, mori në shqyrtim edhe legjitimitetin aktiv të palës paditëse në këtë padi

25.2. Paditësi **Dega e Partisë Demokratike Delvinë**, përfaqësuar nga Kryetari Z. Harilmeri nuk ka qenë subjekt zgjedhor në kuptim të neneve 2(20) dhe 63(1)(2) të Kodit Zgjedhor në të cilën parashikohet shprehimisht: “20. “*Subjekte zgjedhore*” janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, **të regjistruar në përputhje me këtë Kod.**”.

26. Neni 63(1)(2) i Kodit Zgjedhor parashikon se:

“1. Subjekt zgjedhor është një parti politike ose një koalicion partish politike, të cilët paraqesin listë kandidatësh, sipas rregullave që përcaktohen në këtë Kod.

2. Subjekt zgjedhor mund të jetë edhe një shtetas shqiptar me të drejtë vote, i cili propozohet si kandidat për deputet apo për organet e qeverisjes vendore nga një grup zgjedhësish, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Kod.”

26.2 Referuar përcaktimeve ligjore të gjithë subjektet e mësipërme, sipas parashikimeve të vetë dispozitës së sipërcituar, duhet të jenë të regjistruar në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor. Ky parashikim nuk gjen pasqyrim në rastin objekt shqyrtimi.

26.3 Rezulton se pala paditëse, **Dega e Partisë Demokratike Delvinë**, përfaqësuar nga Kryetari Z. Hari Imeri, nuk ka cilësinë e subjektit zgjedhor e për pasojë, në kushtet e rrethanat konkrete, nuk gëzon legjitimitetin aktiv në kërkimin e saj. Si i tillë paditësi, nuk gëzon legjitimim aktiv për të vënë në lëvizje me ankim as KQZ-në dhe as Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor.

26.4 Në thelb, ngritja e padisë, hartimi dhe paraqitja e kërkesëpadisë, janë mjeti procedural me të cilin paditësi vë në lëvizje gjykatën, kur pretendon se ka një të drejtë subjektive, për të njohur a mbrojtur, e cila gjen mbështetje në të drejtën pozitive, si nga pikëpamja materiale ashtu edhe nga ajo procedurale (*për t’iu drejtuar gjykatës*).

26.5 Nëse ajo që, konkretisht, paditësi pretendon se i është cenuar apo që duhet t’i njihet, parashikohet nga e drejta pozitive në aspektin material, e akoma më tej, nëse e drejta pozitive i njeh paditësit të drejtën që këtë të kërkojë ta realizojë nëpërmjet gjykatës, atëherë gjykata ka detyrimin të vijojë me shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjes për të verifikuar nëse ajo kërkohet konkretisht me padi (në objekt) është e mbështetur edhe në prova e në ligj. Në këtë kuptim edhe në rastin e shqyrtimit të ankimeve/padive në një proces zgjedhor, sipas rregullave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, e drejta u përket vetëm subjekteve zgjedhore që garojnë dhe që, për një shkak të caktuar, nuk pajtohen me vendimet e organeve që administrojnë zgjedhjet. Asnjë subjekt tjetër nuk mund të ushtrojë të drejtën e ankimit administrativ, apo të drejtën e inicimit të një procesi gjyqësor pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor.

27. Për sa më sipër Kolegji Zgjedhor vlerëson se padia e paditësit **Dega e Partisë Demokratike Delvinë**, përfaqësuar nga Kryetari Z. Harilmeri duhet të pushohet, për shkak se nuk plotëson para-kushtet e parashikuara në neneve 63, 124 dhe 145 të Kodit Zgjedhor, pasi nuk legjitimohet në ankimin e saj, duke mos i njohur

Kodi Zgjedhor kësaj pale të drejtën për t'iu drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjqësor, pasi nuk është subjekt zgjedhor sipas Kodit.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Zgjedhor Gjqësor, bazuar në nenet 158, 159 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I :

1. Pushimin e Gjykimit të çështjes me nr. 1, datë 04.02.2021 regjistrimi themeltar.
2. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.
3. U shpall sot në Tiranë, më datë: 18.02.2021.

ANËTAR

Asim VOKSHI

ANËTARE

Edlira PETRI

KRYESUESE

Emona MUÇI

ANËTAR

Gentian MEDJA

ANËTARE

Alma KOLGJOKA